

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

LULJETA BORA-BEJLERI

POEZIA SHQIPE E VITEVE '80, MES TRADITËS DHE RISISË

Në ditët e sotme nuk mungon interesi për letërsinë e realizmit socialist dhe fakti që rivlerësimi është proces i përhershëm, mbetet një nxitje për të riinterpretuar një segment të shkurtër kohor brenda vijimësisë së jetës së poezisë shqipe.

Është e qartë se poezia e kësaj periudhe (sidomos deri gjatë mesit të dhjetëvjeçarit për të cilin flasim) s'ka fizionomi dhe strukturë të qëndrueshme, përshkohet prej prirjesh dhe elementesh të ndryshëm, ka përzierje tematike dhe mendojmë se kjo lidhet drejtpërdrejtë me krijuesit: ata që vijnë nga vitet '70¹, ata që startojnë në vitet '80, dhe klasikët modernë Arapi, Agolli, Kadare. Të jemi koshientë; nuk ka vëllime me poezi ku mund të flitet për cilësi të poezive në total. Por ka poezi të mira, ose shumë të mira të qëmtuara në një vëllim, apo të qëmtuara nëpër botimet në organe letrare të kohës. Por, gjithsesi, pavarësisht dobësive dhe kornizave ideologjike, vitet '80, shoqërohen me një prirje masive për një poezi të re e cila përpiqet të devijojë skemat e deriatëhershme.

“Flaka e vjetër”

Së pari poezia shqipe e viteve '80 (kemi parasysh këtu vetëm poezinë brenda kufijve politikë të Shqipërisë) shfaq dukuri kontinuiteti me poezinë e traditës.

Flaka e vjetër; Agolli-Kadare-Arapi, tre poetët që në vitet '60 kërkuan me ngulm largimin nga tema historike-himnizuese dhe vëmendje ndaj motiveve të përditshmërisë, janë bërë tashmë modernë-klasikë. Agolli-poet i tokës, gjithmonë kreativ, jeton në vitet '80 rininë e tij të dytë poetike. Pas tij Arapi-poet i dallgëve e shkëmbinjve të Jonit, gjithashtu boton herë pas here poezi nëpër periodikët letrarë më të rëndësishëm të kohës, ndërkohë që Kadare fare pak, duke i qëndruar besnik konceptit të tij aristokratik për krijimin e poezisë. Të mos anashkalojmë në këtë pikë, censurën ndaj botimeve të dy poetëve të fundit. Kritika i kishte pikasur tendencat e tyre provokuese poetike, që herë turbull e herë më qartë, kishin perspektivë shmangien nga realizmi socialist.

Ëndrra,
ju jeni të rënda
peshherë kërrusem,
nën barrën tuaj
(...)
Ëndrra

¹ Në një artikull të tij, *Poezia shqipe dhe kritika ndaj saj*, 26 qershor 1988, R. Brahimi shpreh se *peshën e botimeve poetike e mbajnë poetët që kanë dalë me përmbledhje të para nga mesi i viteve '70 dhe vazhdojnë të bashkëpunojnë akoma.*

*ju jeni të rënda;
ju ngarkoni mbi mua kafshimet e urive,
Fytyrat e përgjakura, të dhembshura të lirive;
ju ngarkoni mbi mua varrezat e dëshmorëve
të të gjitha kohëve
të të gjithë popujve*

*Dhe bri tyre- si ata-
ju vetë bini tek unë
nëpër funerale gjigante ashtu...*

*Ëndrrat e mia
ju jeni të rënda
Dhe unë s'e kam të lehtë me ju²*

Kjo treshe poetësh, me origjinalitetin e frymëzimit artistik të vargjeve të tyre, luajtën as më pak e as më shumë, rolin e mësuesit për shumë poetë që nisën krijimtarinë e tyre poetike më pas. Madje, vargjet e tyre, të cilët dalluan për shumësi kodesh gjuhësorë e shumëllojshmëri përfytyrimesh e efektesh poetike, përcillëshin me mjaft interes edhe nga lexuesi, i cili në pjesën më të madhe ishte i deformuar në shije mes krijimeve të estetikës së ideologjizuar.

Iluzioni i fjalës, apo poezia e entuziazmit fals?

Poezia e kësaj kohe, sidomos në fillimvitet e saj, dallohet akoma për frymën e të madhërishmes e cila vjen si reminishencë e tradicionalizmit. Karakteristikë e saj janë shkrimi për një tematikë të caktuar, vargu i matur (6-8 dhe 10 rrokësh sipas modelit popullor) dhe toni i ngritur. Tema e luftës dhe ajo historike e kthyer tashmë në mit, kërkohet akoma me këmbëngulje nga redaktorët e periodikëve letrarë dhe ato të shtëpisë botuese më të rëndësishme të kohës, "Naim Frashëri". Një situatë e tillë na kujton thënien e dramaturgut B. Breht "Epokat e shtypjes së madhe janë përgjithësisht epokat në të cilën bëhet më shumë fjalë për madhështinë dhe idealet".

*Po unë kam qenë shpata që jam ngritur
për t'u hakmarrë për gjith hamletët*

*Midis meje e teje
kërpurdha katedralesh
pyje xhamishë,
vetë kullën e Babilonit na ngritën ardhës të
huaj në shteg
Po unë kam qenë ajo dallëndyshja që drejt jete
kam vrapuar
me dy thërime baltë mëmëdheu në sqep³*

² F. Arapi, *Ku shkoni ju statuja*, N. Frashëri, Tiranë, 1990, f. 8.

Arti si shërbyes i shoqërisë, dhe poeti misioner i saj, slogane të kohës, nxitën vargje të tilla si këto më lart. Por, është fakt se pena të tjera, intuita artistike, i shtyu të trajtojnë me origjinalitet, ndjeshmëri të veçantë, në kënde të reja, jo vetëm temën historike, por edhe lëndën folklorike.

Pranë Ajkunës mjeron gjaku

anës gjakut qan Ajkuna

Qaj moj qyqe bar mos mbijë

*vdekjes vetë t'i dridhet buza*⁴

Poetët (përfshi këtu edhe mjaft poetë të mirë) krijuan poezi të cilat i kushtohen atdheut dhe ndryshimeve që ndodhin në të, nxitur edhe prej kërkesës së vazhdueshme së kritikës institucionale për një *lirikë realiste* e cila i bën jehonë ndryshimeve, por pjesë të konsiderueshme të krijimtarive dëshmojnë se nuk ka realizëm, por iluzion të fjalës. E kufizuar dhe e gjendur rëndom mes skemave të gatshme, vargjet iluzore të këtyre poezive pësuan dështim të plotë.

Ja Azotiku, Superfosfati, Metalurgjiku

Mbi supet e punëtorëve ngrihet poezia

Si përmbi skela të sigurta

*Të kapë pikat e diellit në gusht*⁵

Figura të njerëzve të thjeshtë (minatorit, bujkut, muratorit, montatorit, kooperativistes), por në përmasa të modelit që ka për t'u marrë shembull, gjenden rëndom në vargje. Udhëzimet për të qenë afër njeriut të punës dhe për të kërkuar poetikën edhe aty ku s'ka, sollën trajtim të panatyrshëm të motiveve, gjuhë poetike artificiale dhe imazhe të njëtrajtshme. Madje, edhe figura e nënës shpesh u trajtua me mungesë besueshmërie. Ajo doli rëndom si mendimtare, apo patjetër nëna "e dikushit", duke iu larguar imazhit human fillestar. Në poezi të tilla, uni lirik flet pothuaj gjithmonë në vetën e parë, madje dallohet edhe prirja anakronike për të përfshirë mes vargjeve të poezisë emrin e vetë poetit (Ndoc Gjetja, Ndoc Pappleka e Preç Zogajt).

Heroi lirik i poetëve të viteve '80, lufton për jetën dhe parashikon të ardhmen, vendoset me marrëdhënie me kohën, me botën, me njerëzit e afërt dhe me veten, me ndershmërinë dhe urrejtjen, me çiltërsinë, me lakminë, burokracinë, servilizmin, apatinë, ftohtësinë, mepshtësinë njerëzore, guximin, kureshtjen, etj., por rëndom, tipi i poezisë që dënon dukuri negative, i gjen këto tek figura e burokratit, konformistit e karieristit. Në këtë pikë, nuk munguan edhe raste kur këto dukuri arritën forma të tilla që transformonin imazhin e sistemit.

Nuk kanë etikë, as turp: Të kapin nga faqet

³ B. Londo, *Si farë jete*, "Drita", 8.01.1984

⁴ Xh. Spahiu, *Anës gjakut qa Ajkuna*, "Drita", 17.06.1984.

⁵ K. Isai, *Rini e jetës*, "Drita", 8.06.1986.

*Lirisht përtypen, qeshin, ta bëjnë me sy.
Lirisht artikulojnë i dashur, e dashur
Ani se kurrë s'kanë dashur njeri*

*Aktorë kur flasin, kur hanë, kur ecin.
Të rremë, shtijarë edhe kur flenë
Ja, rrugët dhe sheshet trandten ethshëm
Sikur thonë s'jemi skenë⁶*

Motivi i nderimit të punës dhe jetesës me djersë e mundim haset gjithashtu i lëvruar rëndom duke rënë ndonjëherë në banalitet. Letërsia po lodhej me këtë tip poezie.

Poezia kronikë

Poezia kronikë është tipi i veçantë i poezisë së kohës në fjalë e cila merr shkas nga përditshmëria dhe përfshin në vargje fakte të tipit: dukuri, vende, apo emra njerëzish të verifikueshëm të ditës. Në këtë lloj poezie, u dalluan edhe ato poezi, ku figurat marginale, njerëz të thjeshtë të përditshmërisë, trajtohen mes ngjyrave e detajeve të ngrohta të cilat përcillnin optimizëm për jetën, por rëndom në poezinë e viteve '80, në trajtimin e figurave të heronjve të punës, poeti nuk ndalej aq tek madhështia e aktit se sa tek madhështia e fjalës, pasi poetika e jetës u pa jo me natyrshmëri, por me artificialitet.

Modelet e dobëta të poezisë kronikë, të cilat ruajtën vlera fare të përkohshme dhe sot s'na thonë asgjë, janë ato të miteve politikë. Ende në vitet '80, hasen poezi të tilla, ku figurat e LNÇ, rrethohen mes hiperboleve e figurave të sforcuara. Por kjo ishte njëra anë e medaljes, sepse nga ana tjetër, talenti i padiskutueshëm i drejton poetë të caktuar në mënyra të tjera individuale të trajtimit të miteve kombëtare, duke sjellë në të tashmen në mënyrë origjinale mesazhet filozofike të të shkuarës. Trajta të tilla të lëndës poetike e moderuan frymën heroike e konkrete të poezisë (Kemi parasysh këtu ato poezi që ritrajtojnë në mënyrë të moderuar mitet kombëtare; të jetës, të vdekjes, të tokës, në raporte individuale historike, erotike, filozofike.).

Ligjërimi poetik ndaj të thjeshtës dhe “thjeshtëzimi”

Një veçori që do ta shihnim si modernitet të poezisë së viteve '80, është vëmendja ndaj të thjeshtës së jetës. Një pemë qershie që mbushet me lule, një dritë dhome e ndezur deri vonë, aroma e mirë e tokës në mbrëmje, pupat e një fëmije në tel, gruri që lëkundet si një dallgë e stërmadhe e blertë, retë që lëvizin në qiell etj., etj., njëmijë gjëra të vogla që në dukje nuk vlejné për art, bëhen pjesë e një sërë lirikave intime të ndjera të kohës. Poezi, ku ndonjëherë shtillet një lëndë poetike gati naiviste, ruajtën freskinë dhe hijeshinë e të natyrshmes, e njerëzores. Autorët e këtyre lirikave sollën me inteligjencë, emocione të vëzhgimit, të admirimit, të ngazëllimit. Sollën harmoninë e tingujve të përditshmërisë të cilën e përthyejnë në skuta të errëta të shpirtit për të përcjellë ndjesitë. Mirëpo paralelisht me tipin cilësor të lirikave që botohen, u lëvrua një lloj tjetër poezie **tejet përshkruese**.

⁶ P. Zogaj, *Satirë për karnavalet*, “Drita”, 24.09.1989.

Poezia shqipe e viteve '80, mes traditës dhe risisë

Kjo poezi **synon frikshëm konkretësinë** duke mos e njohur trajtën eliptike të shprehjes dhe duke synuar t'i thotë të gjitha me një gjuhë të thjeshtëzuar.

*Vjelësja Vasë
ka një shtëpi të bukur
Një verandë plot hije e dritë
një korridor të çlirët
shtruar me pllaka me motive
Në kuzhinë
një tryezë e shtruar me kujdes
televizori Iliria mbi një komodinë
është mbuluar me një copë të thjeshtë
qëndisur nga Vasa vetë
Vjelësja vjen nga mesi i fushave
dhe çlodhet me fëmijët në divan
shfleton një libër ngadalë
mer një sy gjumë⁷*

Vargje të tilla si këto më sipër, nuk bënin gjë tjetër veçse glorifikonin thjeshtësinë e jetës së lodhshme të këtyre njerëzve të vegjël. Dëshmi e varfërisë, kjo poezi i ngre himn jetës së thjeshtë të njeriut të punës që lodhet shumë dhe kënaqet me pak.

Po në këtë aspekt, nëpër periodikë shiheshin të botuara poezi ku botës shpirtërore të njeriut i zunë vendin makineritë dhe peizazhet e kantierëve. Në këto krijime skematike dhe të cekëta, veç të tjerash dallohej një lloj lidhje e shtirur mes motivit dhe figurave, kjo erdhi si shkak i përsëritjes së një sërë motiveve, të cilët trajtoheshin në të njëjtin këndvështrim, mes figurave të përsëritura. Në mjaft poezi estetikja përcillej e dobësuar dhe estetikja vihej re kollaj. Në këtë pikë, nuk mbetet të themi për cilësinë e poezisë “ashtu ishte koha”. Ç‘na mbetet të themi pastaj për poezinë e Migjenit, Poradecit, Kadaresë, Arapit? Fjala poetike e këtyre krijuesve të shumë dekadave më parë, provokon tek lexuesi ndjenja edhe sot.

Gjithmonë nën tryshninë e sloganit “arti pronë e masave”, duke kollondrisur një letërsi të cilës i imponohej shërbesa, shpesh herë në një tolerancë të justifikuar nga presionet për inkurajim të poetëve të rinj, redaktorët lejonin të botoheshin në periodikë të rëndësishëm letrarë poezi pa vlera. Kjo ishte së pari poezia e të patalentuarve të cilët rendin për t'u afirmuar, dhe së dyti e diletantëve të cilat dalloheshin për mungesë kulture vargëzimi. Sidomos në vitet '83-'86 *lumenj* poezish rrjedhin në faqet e periodikëve. Krijohet përshtypja, se gjithkush mund të botojë, mjaft që të vargëzojë një motiv të pranuar. Tipari më i dukshëm i këtyre poezive pa cilësi është **deklarativja**. Po të gjykosh vetëm nga ajo që sheh të botuar në periodikët letrarë, të duket se poezia humb stilin, humb nervin dhe origjinalitetin. Në këtë lëndë poetike të varfër, prurjet me vlera ku shquhej mbi të

⁷ Xh. Xhaferri, *Shtëpia e vjelësës së pambukut*, “Drita”, 24 shkurt 1985.

gjitha tendenca për pasurim si në frymë si në skema konceptuale të ndërtimit, humbnin. *Sëmundja e poezisë* bëhet aq evidente sa edhe vetë redaktorët që i nënshtroreshin politikës së kohës (vitet '86-'87), kuptojnë që arti i vargëzimit po degradon në botime të krijimeve të kategorisë së diletantëve. Prozaizmi që i dha udhë poezisë së refleksionit dhe shihej nga kritika e kohës si shmangie nga tradita, tek kjo poezi nuk është vlerë.

Qëndrimi i vetëkënaqur i kritikës së kohës që trumbetonte politikën shtetërore për artin, ishte një nga naivitetet, apo gjoja naivitetet e kritikës dhe njëkohësisht një tjetër problem që shoqëroi rrugën e poezisë së viteve '80. Figura të njohura të saj, si: Dallan Shaplo, e Razi Brahimi, qenë nismëtarët e një zhurme të madhe për moslëvrimin e poemës si gjini e gjatë.⁸ Kjo mungesë lëvrimi duhet të lidhet drejtpërdrejtë me koshiençën e disa poetëve të njohur të kohës se dogmat ideologjike nuk vlejnë për art. Dhe duhet theksuar se, janë pikërisht këta poetë të cilët jo thjesht u përpoqën për të gjetur alternativa dalëse nga estetika politizuese, por që njëkohësisht edhe të ndjekin rrugën normale të mbijetesës dhe të zhvillimit të natyrshëm të poezisë shqipe.

Në kërkesën e vazhdueshme për lëvrimin e poemës, po aq sa edhe për temën e madhe, duket qartë *meraku* për shpëputjen e lidhjeve me traditën. Por ky problem i sajuar, ashtu sikurse edhe mendimi i shprehur se lëvrimi i kësaj gjinie duhej të shihej si një kulminacion i zotësisë së poetit, nuk meriton kaq vëmendje, pasi po të ndjekësh botimet, gjatë viteve '84-'85, kuptohet se ndonëse nuk është formë përfaqësuese si gjini poema lëvrohet. Në vitet '80, mëse 40 poema i afrohen lexuesit, ndonëse, një pjesë e tyre shfaqin dobësi të thella duke dalluar nga cilësia e poemave të poetëve të shquar të viteve '60-'70 (Siliqi, Kadare, Agolli, Arapi).

Poema *Epitafi i shtatë ëndrrave* (B. Londo, botuar në Drita, 12.07.1987), ishte një nga poemat, e cila solli për lexuesin jo vetëm tendencën për t'u larguar nga tema e madhe, por edhe mjeshtërinë e vjershërimit dhe modelin sfidues strukturor të fragmentizuar të poezisë së gjatë. Në këtë poemë, vargu thyhet për t'i dhënë rëndësi një fjale të vetme (*vrasja...*) e cila është njëkohësisht konflikti i unit lirik dhe botës së tij morale. Edhe pse kjo poemë merr spunto nga epoka e komunizmit, po ta shohësh na ana e sendërtimit letrar të lëndës dhe frymëzimit, mjeshtërisë së vargëzimit, edhe sot bën jetë aktive letrare dhe dallohet nga poema të tipit: *Ti ishe komunist, Faleminderit det, Vajzë e vogël me jetë të madhe*, të cilat ishin pjesë e vëllimit poetik *Emrin e ka dashuri* (janar 1985) të po këtij autori.

Poezia personale e reflektive

As censura, madje as autocensura nuk mundën dot ta ndalin zhvillimin e poezisë së viteve '80. E kundërta do të ishte e çuditshme dhe e pabesueshme. Citojmë në këtë kontekst studiuesen F. Dado e cila thotë: *A mund të ndodhë që një letërsi 50-vjeçare të zhvillohet vetëm sipas një drejtimi të caktuar? (...) sado i fuqishëm të jetë pushteti mbi drejtimin e let, ekzistojnë ligjshmëri të brendshme*

⁸ Poema dhe kritika për të, "Drita", 6.03.1986.

Poezia shqipe e viteve '80, mes traditës dhe risisë

*mbi të zhvillimi të botës shpirtërore- krijuese, të cilat nuk mund të mbahen plotësisht të mbërthyer vetëm në një drejtim.*⁹

Nga mesi i viteve '80, u dallua qartë përsosja e stilit ndër poetë të tillë si M. Zeqo, B. Londo, N. Gjetja, P. Zogaj, N. Papleka, fakt që provokoi edhe kritikën, e cila e kishte kapur tashmë, dëshirën e madhe për t'iu shpëtuar estetikës së realizmit socialist. Duke parë *harlisjen* e vargut të lirë, u fol ashpër për anarki të formës, por pavarësisht trysnisë së ideologjisë, poezia synonte të bënte një jetë normale. Poetët kishin kuptuar se militarizmi e kishte cinguar poezinë nga natyra e saj. Lavdia e poezisë pllakateske kishte mbaruar. Fryma e lehtë, po aq sa e thellë, intime, fluksi i qetë i ndjesive të qeta që tentonin të çliroheshin nëpër vargje ishin shumë larg modelit të ligjërit të heronjve. Një tis trishtimi shoqëroi herë-herë lirikën e dashurisë dhe të peizazhit në vitet '80. Tonalitetet e poezive, ritmi më i shtruar, gjithë sistemi figurativ u vendos në funksion të magjisë së melankolisë që nxiti nostalgjia për figurën dhe vendet e dashura.

Kur zogu prijës i vjeshtës iku

Shpirti im rrahu krahët në xhama:

(...)

Zuri shi.

Pulla-pulla rëra, deti u nxi

Toka filloi të lëkundet, e ndien?

Gjërat s'durojnë më të thahen!

Rrënjët që lamë në katun në çdo kohë,

janë gati të na lindin

Por prapa resë që vjen rrokullimthi nga Jugu,

me një lule rrufeje në gji,

*Tirana numëron edhe mungesën tonë të vogël.*¹⁰

Dashuria shenjohe si brengë dhe përndeze e metaforizuar, pjesë nga pak e pranishme e dashurisë për vendlindjen, për natyrën, për jetën, për lirinë. Kudo ajo ka lënë gjurmët e saj. Ajo ekziston në gjithë dëshirat dhe shpresat, ajo është një kërkim poetik, misteri shoqëron fjalën poetike. Poeti përpiqet ta qëmtojë atë të pranishme si frymë kudo. Ndryshimi edhe pse i pabujshëm, ishte i dukshëm dhe binte ndesh me ndjenjën e optimizmit fals të hasur dhe të stimuluar deri në atë kohë. Pavarësisht hapësirave të kufizuara, në mjaft raste lirikën e dashurisë të botuara, janë mohime të dukshme të modeleve socrealiste dhe duhet thënë se lënë mbresa të veçanta tek lexuesi.

E mora përdore trishtimin,

shkova ta mbys në lumë,

po rrjedha ishte e cekët

E hodha në krah si hobe,

⁹ F. Dado, Akte të konf. ndërk. 2010/2, *Letërsia shqipe dhe realizmi socialist*, f. 12.

¹⁰ P. Zogaj, *Me ikë*, "Drita", 27.11.1988.

*Shkova ta hedh nga shkëmbi,
por toka ishte afër*

*Atëherë e lidha në djep,
dy ditë e net e përkunda,
por gjumi s'e zuri.*

*Tani bares në rrugë
me trishtimin ti në fytyrë:
Më falni u them të gjithëve¹¹*

*Isha me ty dashuri
Edhe kur u gënjeve
edhe kur u gabove,
edhe kur u marrose,
edhe kur të përzunë nga zjarri jot i vogël,
edhe kur mbete vetëm në shi,
edhe kur humbe rrugën,
edhe kur të tallën me gurë,
edhe kur u fshehe në gjysmëterr
isha me ty dashuri.¹²*

Raste të tilla komentohen nga kritika institucionale, si theksim i panevojshëm i unit poetik, si poza, narcizëm i panevojshëm, bisedë vend e pavend me të dashurën, si doza erotizmi të panevojshme, si imitim i së huajës. Madje, nuk ishin të rralla rastet kur këtyre modeleve që kontrastuan me shabllonit, iu vunë si kundërpeshë motive të dashurisë dhe të natyrës që trajtohen mes lidhjeve me kohën dhe me psikologjinë e njeriut të ditës.¹³ Poezi të tilla të botuara nëpër organe letrare, s'ishin gjë tjetër veçse modele të ndjenjës së kuadratur, apo modele të paaftësisë për të krijuar lirika cilësore të dashurisë.

Pasi ke zgjatur tunelin gjigand në

palcën e malit

Për të shkurtuar largësinë mes njerëzve

dhe të nesërmes

të mendosh

prapa të gjitha mbrëmjeve

fytyrën e dashur

Vargu i shtruar nën shembullin e Uitmanit, metafizika e brendisë, herë-herë e zhvilluar si një monologim, në këto kohë, i dha dorë një poezie antiheroike, ku situatat poetike shpesh ishin të zymta, apo me detaje të errëta, të trishta, pa

¹¹ P. Zogaj, *Pas ndarjes*, "Drita", 24.11. 1989.

¹² Q. Sheme, *Isha me ty dashuri*, "Drita", 21.10.1990.

¹³ D. Shaplllo, *Poezia nëpër kohë*, 1990, f. 121.

Poezia shqipe e viteve '80, mes traditës dhe risisë

gjallërinë e kërkuar nga estetika e realizmi socialist. Ajo që transmetonte kjo poezi ishte humanizmi dhe kjo atmosferë arrihej mes mjeteve specifike; alegorisë dhe nëntekstit që lidheshin me guximin e kërkimeve të reja për një poezi refleksive.

Dua kur të vdes, pas të mos më mbijnë të tillët.

Të shkoj pa u ndier nga kjo botë,ku kam ardhur

pa u ndier

s'e di kush shtratin ku u linda. Përse ta dinë

ku do të bie?

Era ime përmbi truall le të fryjë sa të ketë

takatin

*pa zhurmë gënjeshtare, jam më afër vehtes,
më afër yjeve, dashnorëve, diellit.¹⁴*

Në çastet e mia fatmira

kur koka nuk merret me praktikizma e llogarira

duke më ndërhyrë në taktikat e saj

në punët e brendshme të zemrës

unë ndjej se si bëhem i tëri engjëll

nga krahët më dalin dy flatra të bardha vjershash

dhe ngjitem, dhe ngjitem, dhe ngjitem

deri në lartësitë e plotë të vetes

dhe harroj që jam prej mishi dhe gjaku

harroj si quhem, harroj ditëlindjen,

më duket sikur kam qenë gjithmonë

që në çastin kur është krijuar bota...¹⁵

Kjo poezi racionale, e mendimit ishte pa dyshim atakuese. Ajo nisej nga gjykimi dhe lidhja mes koncepteve që u imponuan mes gjuhës dhe arsytimit. Kështu shumë poezi të viteve '80 janë modele që iu jepen njerëzve për të gjykuar. Në fakt, në rrugën për kërkim shumë poezi të tilla patën vlera relative, pasi ato u karakterizuan nga degë të tepërta të mendimit, të cilat e zbehnin funksionin e elementit poetik, zbehnin fjalën me ngjyrat që sjellin dritëhijet. Këto poezi shpesh erdhën si monologje intime. Si një thjerrëz, uni lirik përthith impulse, e momente si çake të vegjël fotografikë të botës racionale dhe i përthyen ato te vetja. Topika e ligjërit të këtyre vargjeve përpiquej të rrokte probleme të përjetshme të njeriut, duke qenë njëherësh edhe të vetë unit lirik. Ato ruajtën herë-herë tonalitete të bisedës me lexuesin, edhe pse në shumë raste nuk ia dolën t'i shpëtojnë provincializmit poetik.

Brenda natyrës së kësaj poezie, u shkruan edhe poezi të cilat dalloheshin të ndërtuara si një arsytim i ftohtë si një logjikë intelektuale ku dominon relativiteti si formë e të menduarit modern. Këto ishin krijimet të etiketuara nga kritika si

¹⁴ M. Ahmeti, *Dua kur të vdes*, "Drita", 21.10.1990.

¹⁵ N. Gjetja, *Kur shkruaj poezi*, "Zëri i rinisë", 25 janar 1986.

poezi e ftohtë mekaniciste dhe jo interesante. Boshti i tyre ishin ligjërimi i cili mernte vlera kuptimore të shumfishta. Ky tip poezie ndonjëherë mori formën e hajkut.

Muzg

*Kjo pemë do të thahet
do të iki dhe unë sikur të mos kem qenë kurrë*

A do t'i thonë bilbilët këngët që kam thurur?

Zezona

*Ç'mënxyrë ia uli kokën
asaj pishe që s'tundet*

Çdo ditë një sorrë mbi të shkon e ulet.

Bota

*Thellë e më thellë sheh bota brenda meje
atë që unë nuk mundem ta shoh*

E njoh dhe s'e njoh..

Ditë e trishtuar

*Gjelbërim i pabesueshëm,
Gjelbërim pa kufi.*

*Brenda meje
vjeshta e tij.¹⁶*

Vargje të tilla mund të gjesh edhe në poezinë e E. Balluarit, edhe A. Rakipi, B. Balliçi, K. Petriti, B. Mustafaj, S. Mato.

Nga mesi i viteve '80, dallohej madje edhe një ligjërim i veçantë, i cili u barazua nga kritika me *kod poetik i thjeshtëzuar, përdorim i një gjuhe pa ngjyresë emocionale, rëndomësi gjuhësore*¹⁷ etj., por që në fakt, është model i një tipi tjetër poezie që synon të ngërthejë lexuesin në natyrën lodërtare të vargut gjoja transparent në domethënie, larg shtresave të shumfishta të kuptimit, një poezi gjoja e paqëllimtë, si imazh pa domethënie. Këto tekste të tipit të poezisë ideogramë, në të cilat fjalët qëndronin njëkohësisht edhe si objekt fizik hapësinor,

¹⁶ Xh. Spahiu, *Shkurtime*, "Drita", 11 nëntor, 1990.

¹⁷ R. Brahimi, *Motiv kryesor dashuria ndaj njeriut*, "Drita", 15 maj 88, f. 10.

Poezia shqipe e viteve '80, mes traditës dhe risisë

ruanin aftësinë për t'u asimiluar aty për aty si një poezi pikturë. Natyrisht, ne nuk mund të flasim për ekstreme të poezisë konkrete, por vetëm për tendenca, të cilat ç'është e vërteta zënë fill që në vitet '70 në poezinë e M. Zeqos. Natyrisht që poezi të tilla nuk shpëtuan pa u vënë re nga kritika.

*Pikat e shiut vizatojnë rrathë në pellgje,
Era thyen krahët transparent
Nëpër shelgje.*

*Aftësia e çuditshme e çdo pike:
të vizatojë rrathë me saktësi.
Kaq të sakta ndoshta nuk i gjen
as në gjeometri.*

*Bie shi...*¹⁸

*Ajër i tejdukshëm, i lehtë
yje në shkëlqim të ftohtë
koha i hapet vjeshtës
si hapet një hulli në tokë*¹⁹

Poezi të tilla ku mbizotëronte imazhi, i bënë vargjet të hapur ne marrëdhënie me struktura psikologjike, duke ngacmuar në ndjesi lexuesin.

Në përfundim

Poezia shqipe e viteve '80, mbetet mes tipareve të poezisë së traditës dhe prurjeve risi. Ajo njeh dobësi dhe arritje dhe duhet parë në përpjekjet e saj për të kaluar nga një stad, në një stad tjetër zhvillimi. Natyrisht, jemi të ndërgjegjshëm se nuk ka gjykim përfundimtar, pasi kuptimi i plotë i dukurive letrare, ashtu sikurse i veprave, është gjithnjë një proces rritjeje e thellimi, pra, një proces i përgjithësimit të atyre kuptimeve që ia ka zbuluar historia e kritikës dhe lexuesit e shumë epokave. Rivlerësimet do të bëjnë gjithmonë atë që një realitet kritik të mos mbesë i tillë për shumë kohë.

BIBLIOGRAFI

- A. Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980)*, Prishtinë, 1997.
A. Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni*, "Dituria", Tiranë, 2004.
A. Jeferson, D. Roby, *Teoria letrare moderne- një paraqitje krahasuese*, "Albas", Tiranë, 2006.
E. Faye, *Tri biseda me Kadarenë*, "Onufri", Tiranë, 2007.
F. Dado, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, "Onufri", Tiranë, 2006.
F. Dado, *Letërsi e painterpretuar-qasje teorike ndaj Realizmit Socialist*, "Bota shqiptare", Tiranë, 2010.
F. Dado, *Sfida teorike të historiografisë letrare*, "Bota shqiptare", Tiranë, 2009.

¹⁸ F. Haliti, *Bie shi*, Drita, 24.05.1984

¹⁹ Z. Zaloshnja, *Në park*, "Drita" 24.06.1984

- J. Llotman, *Kultura dhe bumi*, Tiranë, 2004.
- L. Topçiu, *Tradita Moderne në letrat shqipe*, “Zenit”, Tiranë, 2010.
- M. P. Pozzato, *Semiotika e tekstit*, “UET/Press”, Tiranë, 2001.
- M. Cika-Kelmendi, *Kadare ndryshe*, “Naimi”, Tiranë, 2009.
- R. Wellek, Ostin Worren, *Teoria e letërsisë*, “Shbe”, Tiranë, 1993.
- R. Qosja, *Shkrimtarë dhe periudha*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2005.
- S. Hamiti, *Letërsia moderne shqipe*, UET-Press, Tiranë, 2009.
- S. Hamiti, *Poetika Shqipe (1. Bioletra, 2. Tematologjia, 3. Albanizma)*, Sh.b “55”, Tiranë, 2010.
- Sh. Sinani, *Letërsia në totalitarizëm dhe “Dossier K”*, “Naimi” Tiranë, 2011.
- Sh. Sinani, *Njerëzit e krisur të Dritëro Agollit*, “Naimi”, 2012.
- T. Çausi, *Fjalor i estetikës*, Ombra GVG, Tiranë, 2005.
- Y. Çiraku, *Shqyrtime kritike nga Historia e letërsisë shqipe*, Albas, Tiranë, 2011.
- GAZETA REVISTA**
- Gazeta “Drita”, të gjithë numrat e viteve 1980-1990.
- Gazeta “Zëri i rinisë”, të gjithë numrat e viteve 1983, 1984, 1985, 1986.
- Revista “Nëntori”, të gjithë numrat e viteve 1980-1990.